



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
- AUTORITETI I KONKURENCËS -  
KOMISIONI I KONKURENCËS

---

V E N D I M

Nr. 446 , Datë 16.01.2017

**“Për Hapjen e Procedurës së Hetimit Paraprak në të gjitha segmentet e tregut të importit, depozitimit, shitjes me shumicë , shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Koço BROKA	Anëtar
Znj.	Iva ZAJMI	Anëtar
Z.	Eduard YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16.01.2017 ,shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Relacionit të Sekretares së Përgjithshme dhe Informacionit të Sektorit të Analizës dhe Studimeve mbi monitorimin e tregut të Gazit të Lëngshëm për konsum familjar dhe biznesin.

**Baza Ligjore:** Nenet 24, (shkronja d) dhe 42, (pika 1) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të:

- Informacionit të Sektorit të Analizës dhe Studimeve mbi monitorimin e tregut të Gazit të Lëngshëm për konsum familjar dhe biznesin.
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në të gjitha segmentet e tregut të importit, depozitimit, shitjes me shumicë, shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes, Nr.7/1Prot., datë 13.01.2017.

**VËREN SE :**

1. Në bazë të nenit 28 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Sektori i Analizës dhe Studimeve i Autoritetit të Konkurrencës ka realizuar një monitorim në tregun e shitjes së gazit të lëngshëm me bombola për familjare dhe biznese.

2. Realizimi i këtij monitorimi u krye pas shqetësimeve të ngritura nga media elektronike dhe e shkruar për një rritje të çmimeve të shitjes me pakicë të GLN për kategorinë familjare dhe biznese, që përdorin këtë produkt për përdorim rezidencial.
3. Tregu i GLN-së funksionon në zbatim të ligjit nr. 8450 datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore, në të cilin përcaktohen qartë rregullat teknike për tregtimin me shumicë dhe pakicë të GLN- së, rregullat e transportit dhe kushtet në të cilat duhet të instalohet dhe përdoret bombola e GLN- së. Pas hyrjes në fuqi të paketës së re fiskale 2017 ku parashikohet vendosja e akcizës për kategorinë GLN vetëm për automjetet në vlerën 8 lekë/litër prej datës 1 Janar 2017.
4. Nga monitorimi konstatohet se në treg ka subjekte që tregtojnë me të njëjtin gomim, sjellje e cila mund të përbëjë shenja të një kufizimi të konkurrencës në shkelje të nenit 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për Konkurrencën", i ndryshuar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 42, pika 1, neneve 4 dhe 9, nenit 24, (shkronja d), të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar),

#### **VENDOSI:**

- I. Hapjen e Procedurës së Hetimit Paraparak në të gjitha segmentet e tregut të importit, depozitimit, shitjes me shumicë, shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
- II. Hetimi Paraparak të përfshijë periudhën kohore nga 01.07.2016 deri në përfundim të periudhës së hetimit.
- III. Raporti i hetimit paraparak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 1 muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**